

20071061390

L I G J

PËR NGARKIM ME BORXH TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM- BANKA BOTËRORE ME MARRËVESHJE PËR HUA PËR PROJEKTIN E DYTË PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË DHE TË TRANSPORTIT NË EVROPËN JUGLINDORE – TTFCE 2

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet me borxh te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim- Banka Botërore me hua në shumë prej 15 000 000 euro, dedikuar për realizimin e Projektit të dytë për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Evropën Juglindore -TTFCE 2.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 të këtij ligji, rregullohen me Marrëveshjen për hua për Projektin e dytë për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Evropën Juglindore -TTFCE 2, e cila do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 17 vjet, me grejs periudhë prej 5 vjetësh. Shkalla e kamatës me të cilën do të servisohet huaja është LIBOR (për euro valutë) plus distanca variabile. Shkalla e kamatës mund të jetë edhe më e vogël varësisht prej vendimeve valide të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Huaja do të paguhet në 24 këste gjysmëvjetore, secila në shumë prej 625 000 euro. Pagesa do të kryhet secilin 15 qershor dhe 15 dhjetor të vitit, duke filluar prej 15 dhjetorit 2012, e duke mbaruar më 15 qershor 2024.

Në grejs periudhën prej 5 vjetësh, që paraqet periudhën e realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Botërore provizion njëtrajtësh në shumë prej 1% të shumës së huas, e cila mund të jetë edhe më e vogël varësisht nga vendimet valide të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Për shumën e mjeteve të patërhequra të huas paguhet provizion i përcaktuar nga ana e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në lartësi prej 0,75% në vit, e cila mund të jetë edhe më e vogël varësisht nga vendimet valide të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Provizioni i mjeteve të patërhequra nga paragrafi 5 i këtij neni paguhet në gjysmëvjetor dhe më 15 qershor dhe më 15 dhjetor çdo vit.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Fondi për rrugët magjistrale dhe rajonale të Republikës së Maqedonisë. Fondit për rrugët magjistrale dhe rajonale të Republikës së Maqedonisë, Drejtorisë Doganore dhe Ndërmarrjes publike për infrastrukturë hekurudhore Hekurudhat e Maqedonisë - Shkup, prej shumës së huas nga Banka Botërore do t'u ndahen shumë eurosh të indeksuar në denarë të një pjese të huas, e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve nga komponentët projektues, realizimi i së cilës është në kompetencat e Drejtorisë Doganore dhe të Ndërmarrjes publike për infrastrukturë hekurudhore Hekurudhat e Maqedonisë - Shkup.

Neni 5

Servisimin e gjithëmbarshtëm të huas nga neni 1 i këtij ligji do ta kryejë Fondi për rrugë magjistrale dhe rajonale i Republikës së Maqedonisë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Në servisimin e obligimeve të huas, në mënyrë përkatëse me mjetet e shfrytëzuar të huas, do të participojnë Drejtoria Doganore nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ndërmarrjes publike për infrastrukturë hekurudhore Hekurudhat e Maqedonisë - Shkup.

Neni 6

Fondi për rrugë magjistrale dhe rajonale dhe Drejtoria Doganore do të lidhin Marrëveshje për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve reciproke të cilat dalin prej Marrëveshjes e cila do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore për realizimin e Projektit të dytë për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Evropën Juglindore - TTFCE 2.

Neni 7

Fondi për rrugët magjistrale dhe rajonale dhe Ndërmarrja publike për infrastrukturë hekurudhore Hekurudhat e Maqedonisë - Shkup do të lidhin marrëveshje për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve reciproke të cilat dalin nga Marrëveshja me e cila do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore për realizimin e Projektit të dytë për lehtësimin e transportit të tregtisë në Evropën Juglindore - TTFCE 2.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.